



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 25.04.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 24.04.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NTP VLORA" për aktivitetin: "Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e Komunës së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-362-121 nxjerr:

V E N D I M

1. Pranohet pjesërisht kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "NTP VLORA" e datës 16.04.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "" Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e Komunës së Prishtinës" me Nr.616 18 362 121 Nr. Brendshëm 616 18 008 121 kundër Njoftimit për dhënje të kontratës të AK -së, të datës 09.03.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet Njoftimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 09.03.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "NTP VLORA " me datë 24.04.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e Komunës së Prishtinës " me numër të prokurimit 616 18 362 121 dhe numër të brendshëm 616 18 008 121.

Autoriteti Kontraktues, me datë 25.04.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1. Lidhur me katalogun e produkteve është konstatuar se pretendimi është i bazuar, pasi që katalogu ka qenë në pliko të veçantë dhe është vendosur bashkë me kopjet e tenderëve. Kjo

është vërtetuar në kohën e çasjes në dokumentacion dhe baza e tillë për eliminim do të hiqet nga raporti i komisionit;

2. Pretendimet lidhur me plotësimin e kërkesave për dëshmitë për furnizime të njehta në vlerën prej 75,000.00 € janë të pa qëndrueshme bazuar në faktet e paraqitura në vijim:

-Tri kontratat e përmendura si kontrata në të cilat ka përfshirje të materialit sportiv janë kontrata që janë paraqitur në Aneksin 6 Lista e kontratave të realizuara si kontrata që në emertimin-përshkrimin e tyre nuk ka asgjë të njejtë apo të ngjajshme me rekuizitat sportive, e që janë si vijon: Furnizimin me material për zyre për të gjitha njësitë kërkuese të KK Novobërdë; Furnizimi me material të zyrës për nevojat e SHCK-së, Arsimit dhe Shëndetësisë (KK Kaçanik) dhe Furnizimi me material administrativ (KK Rahovec); dhe në bazë të kësaj nuk kanë mund të jenë të pranueshme. Ka qenë përgjegjësi e pretenduesit që nëse në kuadër të atyre kontratave ka edhe furnizime me rekuizita sportive ti specifikoj të njejtat dhe të ketë dëshmi të pranimit të atyre mallrave, pasi që në referencat e dorëzuara konstatohet vetëm përfundimi i kontratave pa asnjë specifikim lidhur me llojet e mallrave;

-Poashtu kontratat tjera që i cek si kontrata me përmbajtje 100% sportive e sqarojmë se tri nga ato kontrata kanë dëshmi të realizimit dhe atë si vijon: kontrata me Komunën e Malishevës, kontrata me Shërbimin Korektues të Kosovës dhe Universitetin e Prishtinës, ndërsa për kontratat tjera nuk keni ofruar asnjë lloj dëshmie të realizimit. Për sqarim më korrekt vlera e dëshmive të ofruara është në total 39,425.95 €, ndërsa kërkesa nga FDT-ja është të ofrohen dëshmi për furnizime të njehta në vlerën prej 75,000.00 €;


3. Lidhur me pretendimet për pa rregullësitë në raportin e vlerësimit konstatojmë se janë plotësisht të pa bazuara, pasi që mungesa e një nënshkrimi të një anëtarit nuk do të thotë se nuk ka rekomandim të komisionit, pasi që dy anëtar të komisionit e që paraqesin shumicën e paraparë me dispozita ligjore e kanë paraqitur rekomandime e tyre dhe të njejtin e kam aprovuar si të drejtë; dhe

4. Pretendimi se OE-ik i propozuar për dhënje të kontratës nuk ka të regjistruar në veprimtarinë për shitje të paisjeve sportive-kodi 4764 poashtu është i pa bazuar pasi që as në FDT e as në Specifikimet teknike nuk është kërkuar ndonjë kod i veçantë i regjistrimit të veprimtarive.

Bazuar në konstatimet paraprake konkludojmë se i vetmi pretendim i bazuar i parashtruesit të ankesës është pretendimi për eliminimin e pabazuar lidhur me katalogun, ndërsa pretendimet tjera janë të pa bazuara dhe sipas të njejtave u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit